

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 08 datë 15.03.2018

**Për sigurimin e shëndetit dhe të jetës për punonjësit e
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “e”, të nenit 53 pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “g/1” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, datë 3.11.2014, të ndryshuar, si dhe të nenit 29, shkronja “e” të Rregullores nr. 218, datë 24.7.2008 “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, e ndryshuar, bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë sigurimin e shëndetit dhe të jetës për Drejtorin e Përgjithshëm dhe punonjësit e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, që kanë nënshkruar kontratë pune me afat të pacaktuar me Agjencinë.
2. Të miratojë pagesën e primit të sigurimit për sigurimin shëndetësor dhe sigurimin e jetës deri në masën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për Drejtorin e Përgjithshëm dhe çdo punonjës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Përfitimi i sigurimit të shëndetit dhe jetës për secilin nga punonjësit përfundon automatikisht në rast ndërprerjeje të marrëdhënieve të punës. Punonjësi i përzgjedhur në vendin vakant të krijuar, përfiton të njëjtin mbulim në sigurim sikurse punonjësi i mëparshëm.



KËSHILLI DREJTUES

4. Sigurimi i shëndetit dhe jetës për punonjësit e Agjencisë sipas këtij vendimi të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik.
5. Efektet financiare për qëllim të zbatimit të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar